



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i
Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Dt. 10/10/2018

Ref. nr: 293/01B

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare, nr 82, 21 tetor 2010), nenit 45 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari kërkimore-shkencore, nenin 8 paragrafi 1.4 i Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive 20.03.2011 nxjerr këtë:

V E N D I M

Për anulimin e Konkursit të datës 15.11.2017

1. Anulohet Konkursi i datës 15.11.2017 për "Shkencëtar i vitit 2017 dhe Shkencëtar i Ri i vitit 2017".
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të dispozitave të cekura më lartë, si dhe duke pasur parasysh se Këshilli Shkencor e kalon numrin prej 7 (shtatë) anëtarëve, i formuar jo në përputhje me nenin 45 paragrafin 1 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari kërkimore-shkencore, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kabinetit të Ministrit/MASHt;
2. Sekretarit të Përgjithshëm/MASHt;
3. DSHT/MASHt;
4. Arkivit;

